



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

**MBLEDHJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
APLIKIMEVE (KVA) PËR GBP 2025**

17 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Mbledhjen e hapi z.Sonil Frashëri, Këshilltar i MSHPV në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Aplikimeve. Z.Frashëri përshëndeti të pranishmit dhe bëri një përmbledhje të shkurtër të mbledhjes së mëparshme, ku ishte dakordësuar që Ministria e Mjedisit do të kryente një vlerësim paraprak të kriterit cilësor për Planet e Menaxhimit të Mbetjeve. Ai informoi se Ministria ka përfunduar procesin e vlerësimit dhe ftoi përfaqësuesit përkatës të paraqesin rezultatet.

Z.Dhimitraq Prishka, Drejtor - Drejtoria e Monitorimit dhe Performancës - Ministria e Mjedisit, informoi se, panvarësisht konsultimeve të përbashkëta gjatë procesit nga ana e Ministrisë është bërë vlerësimi paraprak nga ku rezulton se janë 9 bashki të cilat i kanë plotësuar të gjitha kriteret e cilësisë dhe kriteret lidhur me dorëzimin e dokumentacioneve përkatëse sipas Udhëzimit të Përbashkët nr.01, datë 11.07.2025.

Lidhur me Bashkinë Himarë, e cila ishte lënë për shqyrtim të mëtejshëm në mbledhjen e parë, z. Prishka sqaroi se kjo bashki nuk i plotëson kriteret cilësore, pasi nuk përmban elementët thelbësorë të një Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Z.Prishka listoi bashkitë që kanë plotësuar kriteret cilësore si më poshtë: **Dibër, Elbasan, Gramsh, Has, Librazhd, Maliq, Prrenjas, Selenicë dhe Tropojë.**

Z.Frashëri njoftoi se çdo anëtarë i KVA-së disponon dokumentin përkatës të vlerësimit, ku pasqyrohen kriteret cilësore për çdo bashki sipas rezultateve të Ministrisë së Mjedisit.

Z.Prishka shtoi se Ministria ka përgatitur gjithashtu një relacion shpjegues për anëtarët e Komisionit, ku për secilën bashki të kualifikuar janë detajuar kriteret dhe mënyra e përmbushjes së tyre në përputhje me planin vendor.

Z.Fran Brahimi – Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore, u shpreh dakord me gjetjet e paraqitura.

Z.Erton Kashta – HELVETAS/BtF dhe znj.Valbona Karakaçi – HELVETAS/BtF, paraqitën disa pyetje sqaruese lidhur me metodologjinë e ndjekur nga Ministria e Mjedisit në vlerësimin cilësor.

Në përgjigje, z. Prishka dhe z. Frashëri sqaruan se, nga pikëpamja cilësore, janë verifikuar vetëm ato bashki që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë në përputhje me udhëzimin përkatës, dhe se të gjitha bashkitë që kanë plotësuar kriteret janë kualifikuar në vlerësimin cilësor.

Në përmbyllje të diskutimeve, z. Frashëri theksoi se, në zbatim të procedurës, bashkitë kanë afat tre (3) ditë nga data e publikimit për paraqitjen e ankesave të tyre. Pas përfundimit të këtij afati, brenda dy (2) ditësh, KVA do të shqyrtojë ankesat dhe do të dalë me vendimin përfundimtar.

VLERËSIMI PARAPRAK NGA KVA MBI KUALIFIKIMIN E BASHKIVE PËR PLANIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Vlerësimi i KVA për Planin e Menaxhimit të Mbetjeve		
Nr.	Bashkia	Kualifikohet për kriterin e cilësisë në përputhje me udhëzimin (Po/Jo)
1	Dibër	Po
2	Divjakë	Jo
3	Dropull	Jo
4	Elbasan	Po
5	Finiq	Jo
6	Fushë-Arrëz	Jo
7	Gjirokastrë	Jo
8	Gramsh	Po
9	Has	Po
10	Himarë	Jo
11	Kamëz	Jo
12	Kolonjë	Jo
13	Kuçovë	Jo
14	Kukës	Jo
15	Librazhd	Po
16	Lushnje	Jo
17	Malësi e Madhe	Jo
18	Maliq	Po
19	Mat	Jo
20	Memaliaj	Jo
21	Mirëditë	Jo
22	Patos	Jo
23	Peqin	Jo
24	Prrenjas	Po
25	Poliçan	Jo
26	Pustec	Jo
27	Roskovec	Jo
28	Rrogozhinë	Jo
29	Selenicë	Po
30	Shkodër	Jo
31	Tropojë	Po

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve

Lista e anëtarëve të KVA				
Treguesi: Plani vendor i Menaxhimit të Mbetjeve				
Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni në KVA
1	MSHPV	Sonil	Frashëri	Kyetar
2	SHKBSH	Adelina	Farrici	Anëtar
3	MF	Fran	Brahimi	Anëtar
4	MTM/ AKEM	Dhimitraq	Prishka	Anëtar
5	MTM	Blerta	Çali	Anëtar